



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

### **“TERMOHIDRAULIKË”**

**Niveli IV në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit IV të KEK<sup>2</sup>**

**V-IV-23**

**Tiranë, 2023**

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	TERMOHIDRAULIKË			Kodi V-IV-23
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	IV KSHK referuar nivelit IV të KEK	
Qëllimi	Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Termohidraulikë”, Niveli IV KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është përgatitja e individëve për t’u punësuar si teknik në veprimtaritë profesionale që lidhen me termohidraulikën dhe zhvillimi i personalitetit të tyre për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Termohidraulikë” të nivelit IV të KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kanë përfunduar me sukses një nga kualifikimet profesionale të “Termohidraulikë”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK;</li> <li>• Të jenë në kushte shëndetësore që e lejojnë përballimin e kërkesave të këtij niveli të kualifikimit profesional.</li> </ul>			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Termohidraulikë” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale të nivelit dhe Supplementin përkatës, të teknik/menaxherit në këtë kualifikim profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në sektorin e instalimeve të brendshme hidraulike, të sistemeve të ngrohjes, të sistemeve HVAC<sup>3</sup>, të sistemeve termohidraulike me panele diellore, instalimeve UK<sup>4</sup> jashtë ndërtesave etj. Gjithashtu, individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e instalimeve, shërbimeve dhe tregtimit të elementeve përbërëse dhe sistemeve hidraulike e termohidraulike të mësipërme. Me përfundimin e arsimit në drejtimin “Termohidraulikë”, niveli i IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, ai/ajo fiton të drejtën e diplomës së “Maturën Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit	Korrik 2023			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme				

<sup>3</sup> Ngrohje Ventilim dhe Ajër i Kondicionuar (Heat Ventilation and Air Conditioning)

<sup>4</sup> Ujësjellës-Kanalizime

# **STRUKTURA E KUALIFIKIMIT**

## **Rezultatet e të nxënit në:**

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin “Termohidraulikë” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

## **NJOHURI PROFESIONALE**

### **Planifikimi dhe organizimi i punës**

- Të përshkruajë legjislacionin në fuqi në fushën e termoteknikës, hidroteknikës dhe të ndërtimit;
- Të përshkruajë mënyrën e organizimit të punës sipas proceseve dhe posteve;
- Të përshkruajë mënyrën e planifikimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore për realizimin e proceseve të ndryshme të punës;
- Të listojë materialet dhe pajisjet e domosdoshme për realizimin e procesit të punës për instalime në objekt ose terren;
- Të përshkruajë mënyrën e përcaktimit të rezervës së nevojshme materiale (materialet, materialet ndihmëse, vegla pune dhe pajisje etj.), për ecurinë e proceseve të punës;
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të planit të punës dhe grafikut të punimeve duke u mbështetur në projektin dhe zbatimin për pjesët përkatëse të instalimeve hidraulike dhe termohidraulike;
- Të shpjegojë llojet e punimeve dhe radhën e realizimit të tyre për instalimin e një sistemi hidraulik dhe termohidraulik;
- Të përshkruajë hapat e kontrollit teknik dhe përfundimtar, sipas llojit të instalimeve;
- Të përshkruajë mjetet dhe makineritë që përdoren;
- Të listojë dokumentet e magazinimit, të furnizimit apo shpërndarjes së materialeve në kantier, objekt etj.;
- Të rendisë dokumentacionin teknik për realizimin dhe dorëzimin e një instalimi hidraulik dhe termohidraulik sipas legjislacionit në fuqi;
- Të përshkruajë rëndësinë e bashkërendimit të punës me grupet e tjera në objekt apo terren.
- Të përshkruajë përdorimet e programeve kompjuterike si EXCEL (për preventiva/situacione) dhe AutoCAD (për projekte/vizatime sistemesh hidraulike, hidroteknike dhe termohidraulike);
- Të përshkruajë rëndësinë e raportimit periodik tek eprori për realizimin e proceseve të punës;

### **Instalime hidraulike dhe termohidraulike**

- Të përshkruajë elementet e plan organizimit të kantierit të ndërtimit, skemat e furnizimit të energjisë, ujit dhe telekomunikacionit;
- Të interpretojë skemat e sistemit të sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri, skemat e shkarkimeve të ujërave, gazrave, mbetjeve të ngurta etj.;
- Të interpretojë plan organizimin e materialeve të instalimeve hidraulike dhe termohidraulike, mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme përkatëse, sipas dokumentacionit të miratuar;

- Të interpretojë vizatimin teknik të elementeve të ndryshëm, përmasat dhe karakteristikat e materialeve të lidhura me to, tolerancat e lejuara, kushtet teknike, etj.;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit dhe interpretimit të udhëzuesve dhe fletëve shoqëruese të paketimit;
- Të përshkruajë mënyrën e formulimit të propozimeve dhe argumentimin e tyre, lidhur me projektin;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të punimeve përgatitore në terren sipas plan organizimit të punimeve dhe plan vendosjes së objektit;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të punimeve paraprake sipas kushteve teknike të projektit dhe zbatimit të punimeve për instalimet hidraulike dhe termohidraulike;
- Të shpjegojë teknikat e instalimit të linjave të brendshme të furnizimit me ujë të ndërtesave;
- Të shpjegojë teknikat e instalimit të linjave të brendshme të shkarkimit të ndërtesave;
- Të shpjegojë teknikat e shtrimit të linjave të jashtme të ujësjellësit;
- Të shpjegojë mënyrat e realizimit të rrjetit të jashtëm të kanalizimeve;
- Të shpjegojë teknikat e instalimit të linjave të sistemeve termohidraulike;
- Të shpjegojë teknikat e instalimit të linjave të aspirimit dhe ajrimit;
- Të shpjegojë teknikat e instalimit të sistemeve mbrojtëse nga zjarri;
- Të shpjegojë mwnyrat dhe teknikat e instalimit të pajisjeve të specializuara hidraulike;
- Të shpjegojë mënyrat e instalimit të aparaturave, trupave dhe pajisjeve të tjera përbërëse të sistemeve termohidraulike;
- Të shpjegojë teknikat e instalimit të sistemeve të kombinuara hidraulike dhe termohidraulike;
- Të listojë llojet e pajisjeve të specializuara hidraulike
- Të shpjegojë mënyrën e plotësimit të librezës së masave dhe elementet përbërëse të saj;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e manovrimit të saraçineskave për rregullimin e regjimit;

#### **Punime të riparimit dhe mirëmbajtjes së instalimeve hidraulike dhe termohidraulike**

- Të listojë llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes në sistemet hidraulike dhe termohidraulike;
- Të listojë defektet e thjeshta dhe parregullsitë në kryerjen e punimeve të instalimit për sistemet hidraulike dhe termohidraulike, duke gjykuar për shkaqet e tyre;
- Të shpjegojë mënyrat e identifikimit të defektit në sistemet hidraulike dhe termohidraulike;
- Të listojë mjetet e punës për identifikimin dhe riparimin e defektit, si dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit vizual të instalimeve të realizuara;
- Të përshkruajë elementet e grafikut të punimeve të mirëmbajtjes së parashikuar;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e hartimit të një plani mirëmbajtjeje periodike për instalime të ndryshme hidraulike dhe termohidraulike duke parashikuar koston e tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e inspektimeve periodike të nevojshme;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të rezultateve të inspektimit dhe dokumentacionin teknik të mirëmbajtjes dhe riparimeve hidraulike;
- Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së pastrimit dhe lubrifikimit të pajisjeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të kalibrimit të pajisjeve matëse, të mbrojtjes dhe të sigurisë;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të orëve të punës së pjesëve ose tërësinë e pajisjes, sipas manualeve;

- Të shpjegojë rëndësinë e kryerjes së testeve funksionale të të gjitha pajisjeve të instaluara;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrën e riparimit të defekteve të thjeshta dhe parregullsive në kryerjen e punimeve të instalimit në sistemet hidraulike dhe termohidraulike (sipas projektit të riparimit);

### **Sigurimi i cilësisë së punimeve hidraulike dhe termohidraulike**

- Të listojë llojet e standardeve që përdoren në instalimet hidraulike dhe termohidraulike;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të cilësisë së montimit të elementeve mbajtëse, të varjes, dhe të kapjes sipas kushteve teknike të projektit dhe zbatimit;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të cilësisë së punimeve të mbulimit të instalimeve sipas kushteve teknike të projektit dhe zbatimit;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të cilësisë së punimeve të termoizolimit të instalimeve sipas kushteve teknike të projektit dhe zbatimit;
- Të përshkruajë mënyrën e verifikimit të cilësisë së punimeve të instalimit, vendosjes dhe montimit të pajisjeve sipas kushteve teknike të projektit dhe të zbatimit.
- Të tregojë rëndësinë e kontrollit të përputhshmërisë së materialeve dhe pajisjeve të instaluara me projektin;
- Të shpjegojë mënyrat e plotësimit të dokumentacionit teknik për testimet dhe formularit të garancisë për punimet;
- Të përshkruajë llojet e teknikave të testimit dhe rëndësinë e bashkëpunimit në grup;

### **Sipërmarrje dhe edukim karriere**

- Të shpjegojë rolin e sipërmarrjes sociale dhe ekonomike në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
- Të vlerësojë mendime mbi çështje etike që lidhen me veprimtari të ndryshme ekonomike;
- Të përshkruajë bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale të drejtimit termohidraulikë;
- Të listojë parimet e etikës gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale të drejtimit termohidraulikë;
- Të përshkruajë fazat e zhvillimit të biznesit në kontekstin e globalizimit;
- Të analizojë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- Të shpjegojë konceptet financiare (dokumentet financiare, institucionet financiare);
- Të listojë elementët e hartimit të një buxheti;
- Të përshkruajë fazat e menaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme për një projekt të veçantë);
- Të ekzaminojë teknika mbështetëse për të menaxhuar dhe zbatuar një projekt në situata të ndryshme;
- Të ilustrojë metoda të zgjidhjes së problemeve në kontekste të ndryshme;
- Të evidentojë mundësitë që ofron tregu i punës dhe kualifikimet e mëtejshme;
- Të shpjegojë përmes shembujve konceptet e eksternaliteteve dhe të mirave publike;
- Të përshkruajë konceptin e ndërmarrjeve me përgjegjësi sociale në kontekste lokale dhe globale;
- Të analizojë interesat, zotësitë dhe aftësitë personale përmes mënyrave të ndryshme përfshirë vetëvlerësimin.

- Të përshkruajë elementet e përcaktimit të kostos së zbatimit të një projekti;
- Të përshkruajë konceptin e normimit të punës;
- Të përshkruajë elementet e përcaktimit të çmimit të procesit të instalimit apo shërbimit;
- Të interpretojë çmimet e materialeve (kryesore dhe ndihmëse) që përdoren;
- Të shpjegojë parimet bazë të kodit të punës, legjislacionin bazë të fushës së ndërtimit lidhur me aktivitetin që kryen;
- Të përshkruajë format dhe mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
- Të përshkruajë mënyrën e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe të përgatitjes së një oferte;
- Të listojë llojet e faturave dhe mënyrat e plotësimit të tyre;
- Të përshkruajë mënyrat e blerjes së materialeve dhe pajisjeve të ndryshme;
- Të përshkruajë teknika të marketingut;

### **Komunikimi dhe etika profesionale**

- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit dhe teknikat përkatëse;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të Kodit të etikës;
- Të përshkruajë teknikat e punës në grup;
- Të listojë teknikat e zgjidhjes së problemeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e mendimit kritik;
- Të shpjegojë rregullat e komunikimit hierarkik;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të TIK-ut në komunikim;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare;
- Të përshkruajë mënyrën e trajtimit dhe ruajtjes së informacionit;

### **Siguria në punë**

- Të përshkruajë Standardet Shqiptare për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe shëndetit në punë;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar për rregullat dhe intervalet kohore për instruktimin e punonjësve sipas emërimit/proceseve të punimeve të ndërtimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e njohjes së rregullores së brendshme të organizatës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe shëndetit në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të listojë, për çdo post pune, rregullat e sigurimit teknik në punë;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të mbrojtjes dhe shpëtimin nga zjarri;
- Të përshkruajë veprimet e nevojshme për të dhënë ndihmën e shpejtë për të dëmtuarit në punë;
- Të listojë pajisjet e mbrojtjes individuale dhe kolektive në punë;
- Të përshkruajë teknikat e analizimit dhe menaxhimit të rreziqeve në mjedisin e punës;
- Të përshkruajë praktikatat e përgjithshme të sigurisë në vendin e punës, përfshirë sjelljen e punonjësit, praktikatat e mira të mirëmbajtjes së ambientit të punës, praktikatat e sigurisë në lidhje me punën në lartësi, pajisjet e mbrojtjes personale etj.;

- Të vlerësojë menaxhimin e sigurisë ndaj rreziqeve të burimeve të rrymës elektrike, përfshirë parimet e vlerësimit të rrezikut, procedurat e raportimit, masat e kontrollit për të eliminuar ose minimizuar rreziqet;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe evakuimit në raste zjarri, tërmeti, fatkeqësi natyrore etj.;
- Të shpjegojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë dhe mjetet që përdoren;
- Të listojë rreziqet nga zhurmat në mjedisin e punës;
- Të interpretojë sinjalistikën e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit nga shkarkimet e gazrave të dëmshëm në ajër, shkarkimet e lëngjeve e të ujërave të ndotura (infektuara) në mjedise të hapura, të lëndëve të ngurta jomiqësore me mjedisin etj. dhe mënyrën e minimizimit të efekteve të dëmshme në mjedis;

### **Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i tij**

- Të shpjegojë kuptimin për mjedisin, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- Të analizojë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues;
- Të shpjegojë burimet kryesore të mjedisit jetësor;
- Të analizojë ndikimet e mbetjeve në mjedisin jetësor;
- Të shpjegojë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore;
- Të shpjegojë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- Të analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor;
- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të veprimtarive praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

## **SHPREHI PROFESIONALE**

Individi duhet të jetë i aftë:

### **Planifikimi dhe organizimi i punës**

- Të zbatojë legjislacionin në fuqi në fushën e termoteknikës, hidroteknikës dhe të ndërtimit;
- Të organizojë punën sipas proceseve dhe posteve;
- Të planifikojë dhe organizojë burimet njerëzore për realizimin e proceseve të ndryshme të punës;
- Të përzgjedhë materialet dhe pajisjet e domosdoshme për realizimin e procesit të punës për instalime në objekt ose terren;
- Të përcaktojë rezervën e nevojshme materiale (materialet, materialet ndihmëse, veglat e punës, pajisjeve etj.), për ecurinë e proceseve të punës;
- Të hartojë planin e punës dhe grafikun e punimeve duke u mbështetur në projektin e zbatimit për pjesët përkatëse të instalimeve hidraulike dhe termohidraulike;
- Të kontrollojë llojet e punimeve dhe radhën e realizimit të tyre për instalimin e një sistemi hidraulik dhe termohidraulik;
- Të zbatojë hapat e kontrollit teknik dhe përfundimtar, sipas llojit të instalimeve;
- Të përzgjedhë mjetet dhe makineritë sipas proceseve të punës;

- Të plotësojë dokumentet e magazinimit, të furnizimit apo shpërndarjes së materialeve në kantier, objekt etj.;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik për realizimin dhe dorëzimin e një instalimi hidraulik dhe termohidraulik sipas legjislacionit në fuqi;
- Të bashkërendojë punën me grupet e tjera në objekt apo terren;
- Të përdorë bazat e programeve kompjuterike si EXCEL dhe AutoCAD;
- Të raportojë në mënyrë periodike tek eprori për realizimin e proceseve të punës;

### **Instalime hidraulike dhe termohidraulike**

- Të kontrollojë elementet e planorganizimit të kantierit të ndërtimit, skemat e furnizimit të energjisë, ujit dhe telekomunikacionit;
- Të kontrollojë në objekt sistemet e sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri, sistemet e shkarkimeve të ujërave, gazrave, mbetjeve të ngurta etj.
- Të përzgjedhë materialet e instalimeve hidraulike dhe termohidraulike, mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme përkatëse, sipas dokumentacionit të miratuar;
- Të lexojë vizatimet teknike të elementeve të ndryshme, përmasat dhe karakteristikat e materialeve të lidhura me to, tolerancat e lejuara, kushtet teknike, etj.;
- Të përdorë dhe interpretojë udhëzuesit dhe fletët shoqëruese të paketimit;
- Të hartojë propozime të argumentuara, lidhur me projektin;
- Të kontrollojë punimet përgatitore në terren sipas planorganizimit të punimeve dhe plan vendosjes së objektit;
- Të kontrollojë punimet paraprake sipas kushteve teknike të projektit dhe zbatimit të punimeve për instalimet hidraulike dhe termohidraulike;
- Të monitorojë zbatimin e teknikave të instalimit të linjave të brendshme të furnizimit me ujë të ndërtesave;
- Të monitorojë zbatimin e teknikave të instalimit të linjave të brendshme të shkarkimit të ndërtesave;
- Të monitorojë zbatimin e teknikave të shtrimit të linjave të jashtme të ujësjellësit;
- Të monitorojë zbatimin e mënyrave të realizimit të rrjetit të jashtëm të kanalizimeve;
- Të monitorojë zbatimin e teknikave të instalimit të linjave të sistemeve termohidraulike;
- Të monitorojë zbatimin e teknikave të instalimit të linjave të aspirimit dhe ajrimit;
- Të monitorojë zbatimin e teknikave të instalimit të sistemeve mbrojtëse nga zjarri;
- Të monitorojë zbatimin e teknikave të instalimit të pajisjeve të specializuara hidraulike;
- Të monitorojë zbatimin e mënyrave të instalimit të aparaturave, trupave dhe pajisjeve të tjera përbërëse të sistemeve termohidraulike;
- Të monitorojë zbatimin e teknikave të instalimit të sistemeve të kombinuara hidraulike dhe termohidraulike;
- Të përzgjedhë llojet e pajisjeve të specializuara hidraulike;
- Të plotësojë librezën e masave dhe elementet përbërëse të saj;
- Të kontrollojë manovrimin e saraçineskave për rregullimin e regjimit;

### **Punime të riparimit dhe mirëmbajtjes të instalimeve hidraulike dhe termohidraulike**

- Të përcaktojë llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes në sistemet hidraulike dhe termohidraulike;
- Të përcaktojë mënyrat e identifikimit të defektit në sistemet hidraulike dhe termohidraulike;



- Të përzgjedhë mjetet e punës për identifikimin dhe riparimin e defektit dhe përdorimin e tyre;
- Të ndjekë zbatimin e grafikut të punimeve të mirëmbajtjes së parashikuar;
- Të dokumentojë rezultatet e inspektimit dhe dokumentacionin teknik të mirëmbajtjes dhe riparimeve hidraulike;
- Të mbikëqyrë pastrimin dhe lubrifikimin e pajisjeve;
- Të dokumentojë orët e punës së pjesëve ose tërësisë së pajisjeve, sipas manualeve;
- Të identifikojë defektet e thjeshta dhe parregullsitë në kryerjen e punimeve të instalimit për sistemet hidraulike dhe termohidraulike, duke gjykuar për shkaqet e tyre;
- Të ndjekë zbatimin e procedurës dhe mënyrës së riparimit të defekteve të thjeshta dhe parregullsive në kryerjen e punimeve të instalimit, sipas projektit të riparimit;
- Të hartojë një plan mirëmbajtjeje periodike për instalime të ndryshme hidraulike dhe termohidraulike duke parashikuar koston e tyre;

### **Sigurimi i cilësisë së punimeve hidraulike dhe termohidraulike**

- Të kontrollojë vizualisht instalimet e realizuara;
- Të kryejë inspektimet periodike të nevojshme;
- Të verifikojë cilësinë e montimit të elementeve mbajtëse, të varjes dhe të kapjes sipas kushteve teknike të projektit dhe zbatimit;
- Të verifikojë cilësinë e punimeve të mbulimit të instalimeve sipas kushteve teknike të projektit dhe zbatimit;
- Të verifikojë cilësinë e punimeve të termoizolimit të instalimeve sipas kushteve teknike të projektit dhe zbatimit;
- Të verifikojë cilësinë e punimeve të instalimit, vendosjes dhe montimit të pajisjeve sipas kushteve teknike të projektit dhe zbatimit.
- Të kryejë kontrollin e afatit të kalibrimit të pajisjeve matëse, të mbrojtjes dhe të sigurisë;
- Të mbikëqyrë testimin e funksionimit të të gjitha pajisjeve të instaluar;

### **Sipërmarrje dhe edukim karriere**

- Të demonstrojë aftësi për të zhvilluar një projekt ide sipërmarrëse;
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të punës, duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit;
- Të asistojë në hartimin e një kontrate pune individuale;
- Të zbatojë legjislacionin në fuqi në rastin kur kërkon të krijojë një sipërmarrje vetjake;
- Të analizojë të dhëna për të marrë vendimet e duhura në kontekste të ndryshme;
- Të identifikojë dhe të zgjidhë probleme në mënyrë krijuese;
- Të negociojë ide me të tjerët në mënyrë efektive;
- Të vlerësojë risqet sipas proceseve respektive të punimeve të instalimeve;
- Të vlerësojë potencialin personal për të shfrytëzuar avantazhin konkurrues;
- Të mbikëqyrë situata të ndryshme sipas proceseve respektive të punimeve të instalimeve;
- Të aplikojë parimet e ekonomisë së lirë të tregut në situata të ndryshme;
- Të motivojë dhe inkurajojë të tjerët në arritjen e synimeve të tyre;
- Të aplikojë aftësitë për planifikim dhe menaxhim projekti në situata të ndryshme;
- Të sigurojë burimet e duhura dhe të marrë përgjegjësi për t'u kujdesuar për to;

- Të hartojë një plan efektiv biznesi në fushën e punimeve të ndryshme të instalimit, për krijimin e një biznesi, duke u bazuar në procedura standarde;
- Të kryejë detyra tekniko-menaxheriale, nën mbikëqyrje të inxhinierëve, për realizimin e një plan-biznesi.

### **Komunikimi dhe etika profesionale**

- Të komunikojë në mënyrë etike dhe profesionale me kolegët dhe eprorët;
- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit, për të bërë të mundur sigurimin e informacionit nga të gjitha burimet e mundshme;
- Të përdorë saktë terminologjinë teknike dhe profesionale gjatë punimeve të instalimeve të sistemeve hidraulike dhe termohidraulike;
- Të përdorë Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.
- Të zbatojë procedurat e marrjes së informacionit për problemet dhe të rehat e ditës;
- Të zbatojë parimet e punës në grup;
- Të përdorë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të zbatojë kodin e etikës;
- Të zbatojë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik.

### **Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit**

- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, duke përfshirë, përveç aspekteve teknike të sigurisë, plotësimin e dokumentacionit të detyrueshëm për instruktimin e punonjësve;
- Të afishojë, për çdo post pune, rregullat e sigurimit teknik në punë;
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri;
- Të kryejë veprimet e nevojshme për të dhënë ndihmën e shpejtë për të dëmtuarit në punë;
- Të përdorë dhe demonstrojë pajisjet e mbrojtjes individuale dhe kolektive në punë;
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë, përveç aspekteve teknike, plotësimin e dokumentacionit të detyrueshëm për raportimet periodike;
- Të kontrollojë zbatimin e standardeve për grumbullimin dhe depozitimin e mbetjeve nga procesi i punës;
- Të përdorë pajisjet e nevojshme për neutralizimin e efekteve të gazrave të dëmshme, të pajisjeve të pastrimit të ujërave të ndotura dhe të mbetjeve të ngurta që janë jomiqësore mjedisin.

### **Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i tij**

- Të kujdeset për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- Të përdorë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore;
- Të zbatojë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- Të japë kontribut për zgjidhjen e problemeve mjedisore;
- Të realizojë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit;

## KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim dhe me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij, si dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
- Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
- Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
- Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
- Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
- Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
- Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
- Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
- Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
- Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.